



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-BC-2020-07
Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 14 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim i caktimit të datës për paraqitjen e parë dhe çështje të lidhura me të

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit për Hysni Gucatin
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bouden

Mbrojtësit për Nasim Haradinajn
Bastian Martens

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenet 20 dhe 39(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 8(3)(a), 87(6), 92(1) dhe 96 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 shtator 2020, Hysni Gucati (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinaj (“z. Haradinaj”) u arrestuan në zbatim të fletarrestimeve të lëshuara nga Gjykatësi i Vetëm, sipas dyshimit të bazuar se ishin penalisht përgjegjës për veprat penale sipas neneve 387, 388 dhe 392 të Kodit Penal të Kosovës të viti 2019, Ligji Nr. 06/L-074 (“KPK”), në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.²
2. Më 30 tetor 2020, Prokurori i Specializuar paraqiti për konfirmim aktakuzën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (“Aktakuza”) kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj, së bashku me materialin provues në mbështetje të akuzave, si dhe një përmbledhje të detajuar që paraqiste lidhjen e secilës provë me secilën akuzë.³
3. Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konfirmoi pjesërisht Aktakuzën dhe urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) për të paraqitur aktakuzë të rishikuar, siç është konfirmuar (“Aktakuza e Konfirmuar”).⁴

¹ KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik.

² KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni publik i redaktuar i fletarrestimit për Hysni Gucatin*, 24 shtator 2020, publik; F00012/A03/COR/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni publik i redaktuar i versionit të korrigjuar të fletarrestimit për Nasim Haradinajn*, 24 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, F00015, Administratorja, *Njoftim për arrestim sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik.

³ KSC-BC-2020-07, F00063, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesave në lidhje me të*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1 dhe 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00074, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për konfirmimin e Aktakuzës (“Vendimi i konfirmimit”)*, 11 dhjetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

4. Më 14 dhjetor 2020, ZPS-ja paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar,⁵ me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁶ Aktakuza e Konfirmuar i akuzon z. Gucati dhe z. Haradinaj (bashkërisht, “të akuzuarit”) për vepra penale sipas neneve 387,388, 392 dhe 401 të KPK-së, në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.⁷

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Në përputhje me nenin 39(4) të Ligjit, personi kundër të cilit është konfirmuar aktakuza informohet menjëherë për akuzat kundër tij.

6. Në përputhje me rregullat 87(6) dhe 92(1) të Rregullores, i akuzuari nxirret para Gjykatësit të Procedurës Paraprake pa vonesë të papërligjur për paraqitjen e parë.

7. Në përputhje me nenet 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, seancat, duke përfshirë dhe seancën për paraqitjen e parë të të akuzuarit janë publike, përveçse kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos ndryshe in përputhje me Rregulloren.

8. Në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh një konferencë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykimin; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore, ku palëve u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

9. Në përputhje me rregullën 96(2) të Rregullores, konferenca mbi ecurinë e çështjes gjyqësore mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e

⁵ KSC-BC-2020-07, F00075, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së konfirmuar*, 14 dhjetor 2020, publik, me Shtojcën 1 (“Aktakuza e konfirmuar”), rreptësisht konfidencial, dhe Shtojca 2, (“Aktakuza e konfirmuar publike dhe e redaktuar”), publik.

⁶ Vendimi i konfirmimit, para. 155(c).

⁷ Aktakuza e konfirmuar publike dhe e redaktuar, para. 48.

mbrojtësit të tij apo të saj nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit me praninë e mbrojtësit ose me pjesëmarrjen e mbrojtësit përmes videokonferencës.

III. DISKUTIM

A. PARAQITJA E PARË

10. Duke marrë parasysh se të akuzuarit janë aktualisht në paraburgim dhe për të garantuar respektimin e të drejtave të tyre sipas Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme që të caktojë seancat përkatëse për paraqitjen e tyre të parë sa më shpejt që të jetë e realizueshme, duke marrë parasysh disponueshmërinë e mbrojtësve të të akuzuarve dhe kufizimet për shkak të KOVID-19.

11. Gjithashtu, duke marrë shënim se seancat mund të bëhen publike edhe jashtë sallës së gjyqit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon bërjen e fotografive në fillim të secilës seancë për paraqitjen e parë, sipas rastit.

B. GJUHËT E PUNËS

12. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, përveç nëse ka arsye bindëse për t'u shmangur nga vendimi i mëhershëm, anglishtja mbetet gjuha e punës në këtë proces.⁸

13. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se caktimi i gjuhës së punës së procesit nuk ndikon në gjuhën dhe/ose përkthimin e provave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për përdorim nga të akuzuarit.⁹

⁸ KSC-BC-2020-07, F00060, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi gjuhën e punës*, 29 tetor 2020, publik.

⁹ Nenet 21(4)(a) dhe 39(5) të Ligjit; rregullat 86(8), 87(1), 92(2)(b) dhe 102(1) të Rregullores.

C. DATA E KONFERENCËS MBI ECURINË E ÇËSHTJES

14. Gjykatësi i Procedurës Paraprake i fton palët që të bëjnë parashtrime në paraqitjet e tyre të para përkatëse, për të bërë të ditur disponueshmërinë e tyre për konferencë mbi ecurinë e çështjes më 7 janar 2021. Mbrojtja gjithashtu ftohet që të bëjë të ditur në parashtrimet e tyre se a kanë ndërmend mbrojtësit dhe/ose të akuzuarit të marrin pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes përmes pranisë fizike apo përmes videokonferencës, siç përcakton rregulla 96(2).

IV. VENDIM

15. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **VENDOS** të mbajë seancë për paraqitjen e parë të z. Haradinaj, **të martën, 15 dhjetor 2020, në orën 15:00;**
- b) **VENDOS** të mbajë seancë për paraqitjen e parë të z. Gucati, **të premten, 18 dhjetor 2020, në orën 11:00;**
- c) **AUTORIZON** Administratoren që të organizojë në fillim të secilës seancë për paraqitjen e parë, bërjen e fotografive për një minutë e gjysmë, sipas rastit; dhe
- d) **FTON** palët që, në paraqitjet e para përkatëse, të bëjnë parashtrime me gojë, siç përcaktohet në paragrafin 14 më lart, në lidhje me disponueshmërinë e tyre për konferencë mbi ecurinë e çështjes të enjten, 7 janar 2021.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E hënë, 14 dhjetor 2020

Në Hagë, Holandë.